



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 2213 Prot.

Vlorë më, 11.102024

VENDIM

Nr. 16, datë 11.10.2024

**PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË STAFIT AKADEMIK DHE INSTITUCIONALIZIMIN
E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE HYRËS NË UV, NË
KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+KA171**

Në mbështetje të nenit 40, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, referuar vendimit të SA, Nr.19, datë 16.05.2019, "Për miratimin e rregullores për implementimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA 107 International Credit Mobility", në UV, shkresës Nr.2211, prot, datë, 07.10.2024, Rektorati në mbledhjen e datës, 11.10.2024,

VENDOSI:

1. Nëse programi mësimor ku kryhet mobiliteti zhvillohet në gjuhën angleze, studentët e ardhur nga institucionet dërguese i atashohen grupit që zhvillon mësimdhënie në gjuhën angleze, sipas moduleve të dakortësuara përpara mobilitetit.
2. Nëse programi mësimor në UV nuk zhvillohet në gjuhën angleze, do të ngrihet grup mësimor i posatshtëm në gjuhën angleze për studentët e programit Erasmus+KA171, pavarësisht numrit të tyre.
3. Këto grupe / studentë do të institucionalizohen nëpërmjet procesit të regjistrimit të studentëve hyrës në sekretaritë mësimore dhe UVMS, në kuadër të programit Erasmus+KA171.
4. Pedagogët që do të angazhohen në këtë proces mësimdhënieje duhet të plotësojnë kriteret e vendosura nga MASR për mësimdhënie në gjuhë angleze: çertifikatë të njohjes së gjuhës së huaj të nivelit C1 ose diplomë të fituar nga studime në programe në gjuhën angleze në BE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI**

5. Ngarkesa mësimore për modulet në kuadër të programit Erasmus+ KA171 do të njihet si ngarkesë mësimore për pedagogun brenda ngarkesës bazë + 300 orë.
6. Duke pasur parasysh ngarkesën suplementare në përgatitje dhe performancë, ti propozohet Bordit të Administrimit që pagesa e orëve për modulet në gjuhën angleze të llogaritet me 1.5 herë të vlerës së pagesës për orë në gjuhën shqipe.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, Njësitë Kryesore në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

PROF. DR. AURELA SALIAJ

